

Udhëzues dixhital i sigurisë

Shmangni ruajtjen e informacionit tuaj personal dhe PIN kodet në kompjuterin / telefonin tuaj celular.

Certifikata juaj e identitetit është një dokument shumë i rëndësishëm. Prandaj, mos e ruani kopjen e skanuar të certifikatës tuaj të identitetit në kompjuterin tuaj. Sigurohuni që të ndiqni rregullisht informacionin e përdorimit dhe të sigurisë në lidhje me produktin që përdorni. Shmangni mbajtjen e PIN-it të kartës suaj të debitit dhe PIN-it të bankës në internet në kartën tuaj, në portofol ose në çantë ose ruajtjen e tij në telefonin tuaj celular.

Shmangni shkëmbimin e informacioneve tuaja

E-Banking / PIN i bankingut celular, detajet e kartës, PIN i kartës, kodi i aprovimit të celularit të dërguar me SMS dhe fjalëkalimet një herë janë informacioni juaj personal. Për qëllime të sigurisë, duhet të shmangni ndarjen e informacionit të tillë me palë të treta, përfshirë personelin e Bankës sonë.

Sigurohuni që kompjuteri i juaj të jetë i sigurt

Sigurohuni që të përdorni sistemin operativ dhe programet e licencuara dhe azhurnoni rregullisht sistemin tuaj operativ dhe softuerin. Sigurohuni që të përdorni mburoja sigurie të tilla si anti-virus, anti-spyware dhe firewall personal. Shmangni bërjen e transaksioneve bankare në kompjuterë të përbashkët si në internet-kafe, etj.

Shmangni Përgjigjet në E-mail / Thirrjeve të cilat kërkojnë të dhënat tuaja personale

Bankat nuk kërkojnë informacionin tuaj personal ose PIN kodet përmes postës elektronike. Nëse fjalëkalimet tuaja kërkohen me gojë, me shkrim ose përmes Qendrës së thirrjeve, asnjëherë mos jepni informacione në raste të tilla dhe telefononi Kontaktin tonë në +383 38 245 245.

Mos pranoni të merrni ndihmë nga njerëzit, të cilët ju japin numrat e tyre të telefonit për t'ju ndihmuar.

Sigurohuni që niveli i sigurisë së PIN-it tuaj është i lartë

Mos zgjidhni PIN kodin tuaj, që përfshin ditë të veçanta dhe data, numra telefoni, ditëlindjen ose vitin e themelimit të ekipit tuaj të preferuar, të cilat janë të lehta për tu kuptuar.

<https://www.isbankkosova.com/SQ> për të përdorur faqen tonë të internetit, thjesht futni www.isbankkosova.com në shiritin e adresave të shfletuesit tuaj, në vend që të klikoni në ndonjë lidhje. Dega jonë e Internetit përdor protokollin "https".

Shmangni përdorimin e rrjeteve 'wireless', Siguria e të cilave është e panjohur

Metodat pa tel si Wi-Fi, Bluetooth dhe Infrared mund të çojnë në rrezikun e hyrjes së paautorizuar në celularët. Prandaj, shmangni përdorimin e rrjeteve pa tel, siguria e të cilave është e panjohur për ju.

Shmangni pranimin e skedarëve të transferuar përmes Bluetooth, burimi dhe siguria e të cilave është e panjohur për ju; mbani të mbyllura aplikacionet e tilla kur nuk keni nevojë.

Mbroni celularin tuaj përmes aplikacioneve të tilla si Kodi i Sigurisë, Çelësi i kyçjes si dhe përditëso softuerin Anti-Virus me të dhëna aktuale.

Softueri qëllim-keq mund të vjedhë informacione në telefonin tuaj celular, të kërkojë diçka pa dijeninë e përdoruesit ose të dërgojë SMS. Për mbrojtje nga një softuer i tillë;

- Shkarkoni aplikacione mobile nga dyqanet e sigurta të aplikacioneve
- Mos hapni e-mail dhe bashkëngjitje të marra nga persona që nuk i njihni
- Mbështetni mbrojtjen duke përdorur softuer anti-virus